

UDHËZIM
Nr. 1283, datë 16.2.2015

**PËR MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MONETARE TË MINISTRISË
SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES NË LLOGARI TË
THESARIT**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 589 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe neneve 43 dhe 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

UDHËZON:

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit, nga llogaria e thesarit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së detyrimeve monetare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

2. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga Drejtoria e Financës:

a) Me fondet buxhetore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit përkatës, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

3. Drejtoria e Financës çdo vit parashikon fonde buxhetore të planifikuara për shpenzimet, që do të kryejë institucioni, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

4. Në rastin kur Drejtoria e Financës do të bëjë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga ana e përmbaruesit gjyqësor, duhet të jetë depozituar ky dokumentacion:

i) Dokumenti që vërteton njoftimin e njësisë shpenzuese debitore, për ekzekutimin vullnetar dhe të detyrues gjyqësor dhe marrjen dijeni nga ana e tij;

ii) vendimin gjyqësor, i cili në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet si titull ekzekutiv;

iii) kërkesën /urdrin e zyrës përmbarimore, për vendosjen e masës së sekuestros. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose i noterizuar, apo i vërtetuar “njësia me origjinalin”, nga sekretaria e gjykatës.

5. Drejtoria e Financës, brenda 5 (pesë) ditëve, i kërkon degës së thesarit pagesën e shumës së detyrimit nga llogaria e parashikuar, në këtë udhëzim.

6. Në rastet kur Drejtoria e Financës, me fondet buxhetore që ka në dispozicion, nuk është në gjendje të shlyejë as një pjesë të detyrimit sipas vendimit gjyqësor, në bazë të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, kërkon nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për shlyerjen pjesore të detyrimit me fondet e vitit / viteve në vijim, duke bërë edhe njoftimin përkatës, pranë përmbaruesit gjyqësor.

7. Në rast pranimi, nga ana e gjykatës, të kërkesës për ekzekutimin e pjesshëm të vendimit, njësia shpenzuese paraqet një kopje të vendimit të gjykatës në Degën e Thesarit, e cila merr masa dhe e regjistron si angazhim buxhetor të njësisë shpenzuese, të detyrueshëm për t’u zbatuar.

8. Drejtoria e Financës, me përparësi në vitet e ardhshme, planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve të mbartura, duke ndjekur procedurat përkatëse të planifikimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

9. Në shlyerjen e vendimeve gjyqësore nga ana e Drejtorisë së Financës, duhet t’i jepet përparësi shlyerjes së detyrimeve të mëparshme.

Në asnjë rast, nuk mund të vendoset masa e sekuestros mbi të ardhurat në burim të buxhetit të shtetit, pasi ato nuk janë fonde buxhetore të njësisë debitore.

10. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Degët e Thesarit dhe Përmbaruesit Gjyqësor, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj